



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:244759

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644504

KE.nr.465/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit “Qendrimi - Sh” SH.P.K., me numër unik identifikues 810651548, me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xh.K., avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Scardian” Sh.A., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, më datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit “Qendrimi - Sh” SH.P.K., me numër KE.nr.465/22 e datës 25.07.2019, me objekt kontesti kompensim dëmi nga aksidenti i datës 10.01.2018 i konstatuar sipas raportit të aksidentit 2018-CFT-34, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Scardian” Sh.A.

Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi “Qendrimi - Sh” SH.P.K., me datë 25.07.2019, ka paraqitur padi për shpërblimin e dëmit mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia lidhur me aksidentin e datës 10.01.2018 në fshatin Greme, Ferizaj i konstatuar me raportin policor të aksidentit 2018-CFT-34.

Me datë 02.02.2014, paditësi me anë të parashtrësës, e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje juridike e tërheqë padinë e parashtruar më datën 25.07.2019, për arsye se pas dorëzimit të padisë në gjykatë, në këtë lëndë kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore me të paditurin.

Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.465/22, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, bazuar në nenin 261 par. 4 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa.